



AGREE – VEPRIM PËR TË DREJTAT E VAJZAVE PËR BARAZI DHE FUQIZIM!"

IPA III / 2024 / 459-906

Për Skemën e Nëngranteve në kuadër të projektit “AGREE! – Veprim për të Drejtat e Vajzave për Barazi dhe Fuqizim”

Ky dokument ofron përgjigje dhe sqarime për pyetjet e marra në lidhje me Thirrjen për Propozime për Skemën e Nëngranteve në kuadër të projektit “AGREE! – Veprim për të Drejtat e Vajzave për Barazi dhe Fuqizim”.

Përgjigjet e mëposhtme jepen për qëllime sqaruese dhe duhet të lexohen së bashku me Thirrjen për Propozime dhe dokumentet përkatëse të aplikimit. Të gjitha kushtet e tjera, kërkesat e pranueshmërisë, kriteret e vlerësimit dhe procedurat e aplikimit të përcaktuara në Thirrjen për Propozime mbeten të pandryshuara.

Pyetje	Përgjigje
1. A është kjo Thirrje për Propozime e hapur vetëm për organizatat, përfaqësuesit e të cilave kanë marrë pjesë dhe kanë përfunduar tashmë të katër trajnimet tematike në kuadër të projektit AGREE!, apo do të organizohen trajnime shtesë përpara afatit të aplikimit, për t'u mundësuar organizatave të tjera të interesuara të përmbushin këtë kriter pranueshmërie?	Sipas Thirrjes për Propozime, llojet e mëposhtme të subjekteve juridike mund të përfitojnë mbështetje financiare: 1. OJF individuale të regjistruara ligjërisht; 2. Grupe informale të OSHC-ve (grupe prindërisht, OSHC informale) të udhëhequra nga një OJF e regjistruar ligjërisht; 3. Konsorciume informale të OJF-ve, institucioneve arsimore dhe institucioneve të tjera përkatëse, autoriteteve vendore dhe subjekteve të tjera të regjistruara ligjërisht, të udhëhequra nga një OJF e regjistruar ligjërisht. Vetëm OSHC-të formale që përfundojnë paketën e trajnimeve të projektit AGREE! në nivel rajonal, kombëtar ose vendor kanë të drejtë të marrin pjesë në Thirrjen për Propozime si aplikantë. Temat e paketës së trajnimeve janë: (1) gjinia dhe antidiskriminimi; (2) edukimi social dhe financiar; (3) edukimi nga bashkëmoshatarët; dhe (4) ngritja e kapaciteteve të OSHC-ve. Një organizatë që nuk ka përfunduar paketën e kërkuar të trajnimeve të projektit AGREE!

	nuk mund të aplikojë si aplikante. Megjithatë, ajo mund të marrë pjesë si partnere në një projekt të udhëhequr nga një organizatë e pranueshme që i ka përfunduar trajnimet e kërkuara.
2. A është i detyrueshëm përfundimi i të katër trajnimeve tematike?	Po. Sipas Thirrjes për Propozime, kriteret e pranueshmërisë kërkojnë përfundimin e paketës së trajnimeve të projektit AGREE!, e cila mbulon të katër fushat tematike: (1) gjinia dhe antidiskriminimi; (2) edukimi social dhe financiar; (3) edukimi nga bashkëmoshatarët; dhe (4) ngritja e kapaciteteve të OSHC-ve.
3. A mundet një organizatë që nuk ka marrë pjesë deri tani në trajnime t'u bashkohet trajnimeve në këtë fazë dhe të bëhet e pranueshme për të paraqitur një aplikim?	Jo. Përfundimi i paketës së trajnimeve të projektit AGREE! në nivel rajonal, kombëtar ose vendor është një kërkesë pranueshmërie sipas kësaj Thirrjeje për Propozime. Një organizatë që nuk ka përfunduar paketën e kërkuar të trajnimeve të projektit AGREE! nuk mund të aplikojë si aplikante. Megjithatë, ajo mund të marrë pjesë si partnere në një projekt të udhëhequr nga një organizatë e pranueshme që i ka përfunduar trajnimet e kërkuara.
4. A inkurajohen projektet që përfshijnë partneritete ndërmjet organizatave nga zonat urbane dhe bashkive në zonat rurale, me synim zvogëlimin e pabarazive rajonale, dhe a do të marrin këto projekte pikë shtesë?	Kriteret e vlerësimit dhe sistemi përkatës i pikëzimit përcaktohen në Tabelën e Vlerësimit të përfshirë në Thirrjen për Propozime. Cilësia e aplikimeve do të vlerësohet në përputhje me kriteret dhe sistemin e pikëzimit të përcaktuar në këtë Tabelë Vlerësimi.
5. A do të konsiderohet avantazh nëse aktivitetet e propozuara janë pjesë e strategjisë afatgjatë të organizatës dhe kanë potencial për të vazhduar edhe pas përfundimit të grantit?	Cilësia e aplikimeve do të vlerësohet në përputhje me kriteret e vlerësimit dhe sistemin e pikëzimit të përcaktuar në Tabelën e Vlerësimit të përfshirë në Thirrjen për Propozime.
6. Në cilën kategori buxhetore duhet të paraqiten pagat dhe kontributet për punonjësit e angazhuar drejtpërdrejt në zbatimin e projektit? A është e përshtatshme që këto kosto të përfshihen në kategorinë "Kosto Direkte", duke përcaktuar qartë pozicionin, periudhën/përqindjen e angazhimit dhe kontributet përkatëse?	Kostot që lidhen me pagat dhe kontributet për punonjësit e angazhuar drejtpërdrejt në zbatimin e projektit mund të përfshihen në kategorinë "Kosto Direkte". Pozicioni, periudha dhe/ose përqindja e angazhimit, si dhe kostot dhe kontributet përkatëse, duhet të specifikohen qartë dhe të justifikohen në raport me aktivitetet e propozuara të projektit. Ju lutemi, vini re se Burimet Njerëzore nuk mund të tejkalojnë 25% të buxhetit. Ju lutemi, vini re se, sipas Thirrjes për

	Propozime, pagat e stafit që nuk është i angazhuar drejtpërdrejt në projekt, si dhe pagesat shitesë për stafin që nuk justifikohen nga aktivitetet e projektit, konsiderohen kosto të papranueshme.
7. Cilit partner të projektit AGREE! duhet t'ia dorëzojë një organizatë aplikimin e saj në kuadër të Thirrjes për Nëngrante?	Organizatrat që plotësojnë kërkesat e pranueshmërisë të përcaktuara në Thirrjen për Propozime duhet t'ia dorëzojnë aplikimin partnerit të projektit AGREE! përgjegjës për Thirrjen për Nëngrante në vendin ku organizata është e regjistruar ligjërisht. Për shembull, organizatat e regjistruara në Serbi duhet të aplikojnë përmes partnerit të projektit AGREE! që zbaton Thirrjen për Nëngrante në Serbi. I njëjti parim zbatohet për organizatat e pranueshme të regjistruara në vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor (Shqipëri, Bosnjë dhe Hercegovinë, Kosovë*, Mal i Zi, Maqedoni e Veriut) dhe në Turqiye, të përfshira në Skemën e Nëngranteve. Aktivitetet e propozuara duhet të zbatohen në vendin përkatës, në përputhje me kërkesat për vendndodhjen të përcaktuara në Thirrjen përkatëse për Propozime.
8. A ka kritere financiare për aplikantët potencialë lidhur me buxhetin/të ardhurat minimale ose maksimale vjetore të organizatës gjatë vitit të kaluar, apo organizatat mund të aplikojnë pavarësisht madhësisë së buxhetit të tyre vjetor?	Thirrja për Propozime nuk përcakton kërkesa për buxhet ose të ardhura minimale apo maksimale vjetore për aplikantët. Organizatat që plotësojnë kërkesat e pranueshmërisë të përcaktuara në Thirrjen për Propozime mund të aplikojnë pavarësisht madhësisë së buxhetit të tyre vjetor. Megjithatë, aplikantëve u kërkohet të paraqesin raportin e tyre narrativ/financiar për vitin e kaluar (2025) si pjesë e paketës së aplikimit.
9. A duhet që të gjithë anëtarët e ekipit të projektit të organizatës aplikuese të kenë përfunduar paketën e trajnimeve të projektit AGREE!, apo mjafton që një përfaqësues i organizatës t'i ketë përfunduar trajnimet?	Nuk kërkohet që të gjithë anëtarët e ekipit të projektit të kenë përfunduar paketën e trajnimeve të projektit AGREE!. Përfundimi i paketës së kërkuar të trajnimeve nga të paktën një përfaqësues i organizatës është i mjaftueshëm që organizata të përmbushë këtë kërkesë pranueshmërie.
10. Nëse një përfaqësues që ka përfunduar paketën e trajnimeve të projektit AGREE! ka marrë pjesë në	Jo. Pjesëmarrja në paketën e trajnimeve të projektit AGREE! nga një përfaqësues i një organizate që është anëtare e një rrjeti nuk e

emër të një organizate që është anëtare e një rrjeti, a mund të aplikojë rrjeti në Thirrjen për Nëngrante mbi bazën e pjesëmarrjes së atij përfaqësuesi?	bën automatikisht rrjetin të pranueshëm për të aplikuar. Organizata që është përfaqësuar në trajnime mund të aplikojë, me kusht që të përmbushë edhe kriteret e tjera të pranueshmërisë të përcaktuara në Thirrjen për Propozime. Rrjeti mund të përfshihet si partner në projektin e propozuar, në përputhje me kushtet dhe format e bashkëpunimit të parashikuara në Thirrjen për Propozime. Sipas Thirrjes për Propozime, llojet e mëposhtme të subjekteve juridike mund të përfitojnë mbështetje financiare: 1. OJF individuale të regjistruara ligjërisht; 2. Grupe informale të OSHC-ve (grupe prindërisht, OSHC informale) të udhëhequra nga një OJF e regjistruar ligjërisht; 3. Konsorciume informale të OJF-ve, institucioneve arsimore dhe institucioneve të tjera përkatëse, autoriteteve vendore dhe subjekteve të tjera të regjistruara ligjërisht, të udhëhequra nga një OJF e regjistruar ligjërisht.
11. Çfarë duhet të bëjë një aplikant nëse has vështirësi në shkarkimin e dokumenteve të aplikimit të publikuara në kuadër të Thirrjes për Propozime?	Të gjitha dokumentet dhe modellet e aplikimit janë të disponueshme si pjesë e Thirrjes për Propozime të publikuar. Në rast vështirësish në aksesimin ose shkarkimin e dokumenteve, aplikantët mund të kontaktojnë partnerin përkatës të projektit AGREE! përgjegjës për Thirrjen në vendin e tyre, për të kërkuar dokumentet e aplikimit.